



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:269457

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05408522

CP.nr.357/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË / DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtaren Hatixhe Begaj, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit R. H. mësimdhënës pranë Gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malishevë, të cilin me autorizim e përfaqëson av.Bestar Kolgeci me adresë Rr. “De Rada” nr.6 Prizren, kundër debitorit Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, e përfaqësuar nga avokati publik i komunës Mujë Sahitaj, lidhur me kompensimin e shujtave ditore në shumën prej 370.00 euro, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorit, kundër Aktvendimit për lejimin e përmbarimit CP.nr.357/21 të datës 10.05.2022, jashtë seancës, me 05.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

HEDHET prapësimi i debitorit Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson avokati publik i komunës Mujë Sahitaj, i ushtruar kundër Aktvendimit për lejimin e përmbarimit CP.nr.357/21 të datës 10.05.2022, si i PA AFATSHËM.

A r s y e t i m

Kreditori R. H. të cilin me autorizim e përfaqëson av.Bestar Kolgeci, përmes propozimit për përmbarim ka kërkuar përmbarimin e shumës së borxhit në emër të shpenzimeve të ushqimit (shujtave) në punë, në shumën prej 370.00 euro. Gjykata duke vepruar sipas propozimit të kreditorit me aktvendimin CP.nr.357/21 me dt. 10.05.2022 ka lejuar përmbarimin në këtë çështje përmbarimore në bazë të vendimit administrativ me nr.397/2021 të dt.03.09.2021 të lëshuar nga MFPT / Inspektorati i Punës – Prizren.

Pas lejimit të përmbarimit me Aktvendimin CP.nr.357/21 të dt.10.05.2022, të njëjtin gjykata ia ka dorëzuar debitorit të cilin e ka pranuar me datë 23.05.2022 me paralajmërimin se pala e pakënaqur ka të drejt të paraqes prapësim në afat 7 ditor nga dita e pranimit të të njëjtit.

Debitori, Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale e Arsimit përmes përfaqësuesit të saj avokati publik i komunës Mujë Sahitaj ka ushtruar prapësim me dt:10.06.2022 kundër Aktvendimit për lejimin e përmbarimit CP.nr.357/21 të dt. 10.05.2022, me te cilën është lejuar përmbarimi sipas propozimit të kreditorit: R. H., për përmbarimin e borxhit në shumën prej 370.00 €.

Nga shkresat e lëndës vërehet se prapësimi është dërguar përmes dorëzimit fizik, e që data e pranimit të Aktvendimit për lejimin e përmbarimit CP.nr.357/21 me dt. 10.05.2022 nga ana e debitorit është data 23.05.2022, e që rezulton se prapësimi është i pa afatshëm.

Afati kohor ligjor për ushtrim të prapësimit ka qenë afati prej 7 ditësh siç është dhënë edhe në udhëzimin juridik në Aktvendimin CP.nr.357/21 me dt. 10.05.2022, i cili ligjërisht ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme prej kur debitori e ka pranuar Aktvendimin e tillë, që në rastin konkret i bie të ketë filluar nga data 24.05.2022, e ku me shikim në kalendarin mujor – maj për vitin 2022, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit – duke marrë afatin e dhënë në udhëzimin juridik ka qenë data 30.05.2022 (ditë e hënë), datë kjo kur edhe ka skaduar afati kohor ligjor prej 7 ditësh i dhënë në udhëzimin juridik.

Nga kjo rezulton se debitori ka paraqitur prapësim 11 ditë me vonesë, pra jashtë afatit kohor. Afatet kohore të përcaktuara me ligj, janë të pandryshueshme dhe nuk mund të zgjaten apo shkurtohen as me vendim të gjykatës e as me marrëveshjen e palëve. Afati ligjor ka karakter prekluziv, sepse veprimi procedural i lidhur për afatin ligjor nuk mund të kryhet pas skadimit të tij.

Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike, gjykata vlerëson se debitori prapësimin kundër Aktvendimit mbi lejimin e përmbarimit nuk e ka ushtruar brenda afatit ligjor të paraparë me nenin 70 të LPP-së, (afati 7 ditë).

Mbi bazën e asaj që u tha më lartë, në kuptim të nenit 73 par. 3 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/ DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil

CP.nr.357/21, datë 05.03.2024

G j y q t a r j a

Hatixhe Begaj

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.